



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PUKË**  
**DREJTORIA E MENAXHIMIT FINANCIARE**

Nr. 1890 prot:

Pukë, më 07/08 2024

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. 2, Datë    /   /    2024

**PËR**

**“PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDIT TË ZËRAVE NGA SHPENZIME KORENTE TEK SHPENZIME PËR INVESTIME BRENDA TE NJEJTIT PROGRAM PËR VITIN 2024”**

Këshilli i Bashkisë Pukë, sot me datë    /   /    2024, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 date 17.12.2015 “Per Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar te ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar; ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar ; ligjit 97/2023 datë 30.10.2006 “Për Buxhetin e vitit 2024”; ligjit 97, datë 07.12.2023 “Për buxhetin e vitit 2024” Udhëzimin të Ministrisë Financave nr 9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.1 datë 24.01.2024 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024”; VKB nr 47 datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtarë 2024-2026 të Bashkisë Pukë” i ndryshuar sipas materialit të përgatitur nga administrata e bashkisë dhe me propozim të kryetarit me     (     ) vota pro .

**VENDOSI**

1- Miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave nga shpenzime korente tek shpenzimet për investime brenda programit 06260 “Shërbimet Publike Vendore” si me poshtë:

**a-Pakësohet:**

Në mijë/lekë

Nr	Emertimi i strukturës	Kod Prog	Kapitull	Llog.Ekonomike	Shuma
1	Shërbimet Publike Vendore	06260	01	602 (mallra dhe sherbime)	2012
	Totali				2012

**b-Shtohet:**

Në mijë/lekë

Nr	Emertimi i strukturës	Kod Prog	Kapitull	Llog.Ekonomike	Shuma
1	Shërbimet Publike Vendore	06260	01	231(shp. per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	2012
	Totali				2012

2 - Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë

3- Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6 te ligjit . 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore“.

Shpallur me datë \_\_\_\_ \_\_\_\_ 2024

**Drejtores e Financës**

Fiqirete Latifi



**Juristi**

Endrit Kraja



**KRYETARI**

Rrok DODAJ



## RELACION

### **“PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDIT TË ZËRAVE NGA SHPENZIME KORENTE TEK SHPENZIME PËR INVESTIME BRENDA TE NJEJTIT PROGRAM PËR VITIN 2024”**

DREJTUAR!  
KESHILLIT BASHKIAK

#### **Të nderuar Këshilltare!**

Në mbështetje të nenit 27, neni 54 gërma “dh” të ligjit nr. 139/2015 date 17.12.2015 “Per Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar të ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar; ligjit 10296 date 08.07.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar ; ligjit 97/2023 datë 30.10.2006 “Për Buxhetin e vitit 2024”; Udhëzimin të Ministrisë Financave nr 9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.1 datë 24.01.2024 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024”; VKB nr 47 datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtarë 2024-2026 të Bashkisë Pukë” relatojme se:

Ne buxhetin e viti Bashkia ka prashikuar likujdim të detyrimeve të prapambetura, me qëllim uljen e borxhit, buxhetin për likujdim të detyrimeve e kemi parashikuar në strukturën e shërbimeve publike vendore në Shumen 11.000 mijë leke në llogjën ekonomike 602. nga analiza e bërë për likujdimet e detyrimeve në rekordim dhe me degen e Thesarit në të cilën janë regjistruar me urdhera këto detyrime, kërkojmë se duke qenë se një pjesë e këtyre detyrimeve ju përket investimeve të bëra në vite sipas kontratave, por të palikujduara, është detyrim dhe financiarë që këto detyrime të likujdohen jo me artikullin 602 - shërbime, por me artikullin 231 – shpenzime për investime, që i shtohen vlerës së objektit. Nga 11.000 leke kërkojmë që 2.012 mijë leke të kalojmë në llogjën ekonomike 231- investime.

Sqarojmë se këto detyrime janë të vitit 2012 dhe si të tilla duhen likujduar të parat. Bazuar në arsyetimin e mesipërm.

Kërkojmë ndryshime në buxhet

#### **a-Pakësohet**

					Ne mijë/leke
Nr	Emertimi i strukturës	Kod Prog	Kapitull	Llogj. Ekonomike	Shuma
1	Shërbimet Publike Vendore	06260	01	602 (mallra dhe shërbime)	2012

#### **b-Shtohet:**

					Ne mijë/leke
Nr	Emertimi i strukturës	Kod Prog	Kapitull	Llogj. Ekonomike	Shuma
1	Shërbimet Publike Vendore	06260	01	231 (shpërritje aktiveve qend)	2012

**Drejtoresha e Financës**

Fiqirete Latifi

**KRYETARI**  
Rrok DODAJ